



Mësimdhënia e sotme dhe mësimi i gjuhëve të huaja

MSc. Albana Aliaj

Abstract

Teaching today is a devotion, desire commitment, fulfilling the aspirations of many individuals that see as untouchable as they still recall their teachers. But teaching is not only related to the school or auditorium banks, it is because there is a wide range of factors. Teaching is an art and complex process, is undivided part of defined ages, because the study does not recognize age. If someone learns a foreign language will familiarize the factors that affect in it.

Learning a foreign language is not only culture and means of communication but now often a necessity. Pronounce that the time, development of the world, civilization and detect powerfully that individual should have as part of his being.

Time needed to learn a foreign language will depend a lot on various factors such as age, purpose, occupation and climate that surrounds us in this society that moves and walks to catch the Standards and Values. It is the individual who decides whether to be part of achieving success, and values after properly resolved method and its adaptation to his intellectual level.

It is not easy to learn a foreign language because there are only words and phrases to be learned, but the real linguistic knowledge, lexical, linguistic and phonetic. But even difficult to learn a foreign language is not because the world is open, has exchange of experiences and today is the optimal time to learn a foreign language, since technology is affecting the world and not a mere mortal like us.

If learning a foreign language, you are a vided one, one with a lot of cultural value, honor and respect yourself in this society.

Abstrakt

Mësimdhënia e sotme është një përkushtim, dëshirë, përbushje e aspiratave të shumë individëve që e shohin si të paprekshëm pasi kujtojnë ende mësuesit e tyre. Por mësimdhënia nuk lidhet vetëm me bankat e shkollës apo auditoret, ajo është më e gjerë sepsë ka një sërë faktorësh. Mësimdhënia është një art dhe proces kompleks, është pjesë e pandshme për grupmoshat e caktuar, sepse studimi nuk njih moshë. Nëse dikush

mëson një gjuhë të huaj do të njoh nga afër faktorët që ndikojnë në të.

Të mësosh një gjuhë të huaj nuk është vetëm kulturë dhe mjet komunikimi por tani shpesh herë një domosdoshmeri. Shprehem në këtë mënyrë se koha zhvillimi dhe civilizimi i botës dikton fuqishëm, që individi duhet të këtë si pjesë të qënie së tij.

Koha që të nevojitet për të mësuar një gjuhë të huaj do të varet shumë nga faktorë të ndryshëm si : mosha, qëllimi, profesioni dhe klima që na rrethon në këtë shoqëri që ecën dhe ecën për të kapur Standartet dhe Vlerat. Është individi ai që vendos nëse do të jetë pjesë e suksesit e arritjes, dhe vlerave pasi ka zgjidhur në mënyrën e duhur metodën dhe përshtatjen e saj me nivelin e tij intelektual. Nuk është e lehtë të mësosh një gjuhë të huaj sepsë nuk janë vetëm fjalë dhe shprehje për t'u përvetësuar, por njohuri të mirëfillta gjuhësore, leksikore, lingvistike dhe fonetike. Por edhe e vështirë të mësosh një gjuhë të huaj nuk është sepsë bota është e hapur, ka shkëmbim eksperiencash dhe sot është koha optimale të mësosh një gjuhë të huaj, pasi teknologjia po ndikon botën dhe jo më një njëri të thjeshtë si ne.

Nëse mëson një gjuhë të huaj je dikush, je një njëri me shumë vlera kulturore, nderon dhe respekton veten në këtë shoqëri.

* * *

Mësimdhënia është një fjalë sa e bukur aq edhe domethënëse e kuptimplotë në thelb.

Të gjithë shqiptarët dëshirojnë të mësojnë gjuhë të huaja, të gjithë punojnë, harxhojnë energji, përpiqen të përvetësojnë sa më shumë të munden, ka raste që ndalojnë së mësuarit por përsëri fillojnë nga e para për të arritur qëllimin kryesor që i kanë vendosur vetvetes, suksesin. Rëndësia e një gjuhe të huaj është shumë e rëndësishme për çdo njeri në botë, të gjithë e vlerësojnë atë pa dallim shtrese shoqërore, intelektuale dhe akademike. Jemi koshient për domosdoshmërinë e përdorimit të saj në të gjitha fushat e jetës. Të gjithë mësuesit, nxënësit dhe në veçanti prindërit, të cilët shpeshherë i nxitin fëmijët e tyre të mësojnë qoftë edhe një gjuhë të huaj, konkretisht gjuhën angleze, bëjnë përpjekje të mëdha të fitojnë sa më shumë njohuri mbi gjuhën e huaj e cila i duhet për një të ardhme sa më të mirë në jetë. Përdorimi dhe domosdoshmëria e gjuhëve të huaja, kryesisht anglishtja, si një ndër gjuhët parësore



dhe shumë të përdorur në ditët e sotme, anëmbanë rruzullit tokësor.

Pa u zgatur më shumë dhe në të njëjtën kohë të hyjmë në detaje specifike, ne duhet patjetër të shikojmë dhe të flasim mbi praktikën dhe mësimin real të gjuhëve të huaja në jetën e përditshme, përdorimin dhe zhvillimin e tyre qoftë në shkollë, sidomos në ato specifike për gjuhët e huaja apo edhe jashtë tyre, në kurset e organizuara nga mësues apo shoqata të ndryshme, gjithashtu kemi edhe njerëz autodidakt që punojnë për një qëllim të caktuar. Sot kemi shumë mundësi për marrjen e informacioneve të ndryshme përmes botimeve të pafundme, fjalorëve, metodave që të gjithë bashkë ndikojnë në mësim-nxënien e gjuhëve të huaja, të anglishtes. Por në të njëjtën kohë duhet të përzgjedhim saktë llojin e teksteve dhe metodologjitë përkatëse të të mësuarit dhe të nxënimit të gjuhës së huaj sepse ekziston një gamë tepër e gjërë burimesh, informacionesh, si dhe disinformacione të cilat na largojnë nga praktika, mësimi konkret i ndërtuar me objektiva e synime të matshme për një qëllim të caktuar. Në këtë material unë do të fokusohesha në procesin se si janë mësuar dhe shpjeguar gjuhët e huaja duke pasqyruar disa rekomandime nga studimet dhe eksperiencat profesionale në vite. Të përpiqemi të fokusohemi në disa pyetje :

- Si i mësojnë njerëzit gjuhët e huaja?
- Faktorët që ndikojnë në mësimdhënien e gjuhës së huaj te njerëzit.

Mësimi është një proces aktiv, kjo është shumë e thjeshtë për t'u kuptuar teorikisht por shumë e vështirë për t'u zbatuar në praktikë. Mësimi aktiv mund të aplikohet në çdo mësim që duam dhe jo vetëm në mësimin e gjuhëve të huaja. Ndërkohë, mësimi aktiv nuk kërkon vetëm thithjen e informacionit ashtu si sfungjeri thith uj, por ne përpiqemi t'a kuptojmë informacionin e ri duke e përshtatur dhe lidhur me ato njohuri që kemi përvetësuar. Pra, në këtë mënyrë ne përpiqemi të përshtatim njohurinë e reja me ato të vjetra.

Për shembull: Kur ne dëgjojmë një fjalë në gjuhën angleze, në momentin e parë shohim nëse ekziston një ngjashmëri me këtë fjalë në gjuhën e nënës, më pas shohim nëse kjo fjalë ka një tjetër fjalë anglisht, një sinonim që mund t'a dimë më parë si : armchair (arm - chair) . Së fundi shohim kuptimin e fjalëve të tjera ne tekst duke kuptuar fjalën e panjohur përmes kontekstit. Disa faktorë që ndikojnë në mësimin e gjuhës së huaj.

I. Faktorët psikologjikë përfshijnë:

- Motivimi** – lidhet me faktin se sa të interesuar janë individët në mësimin e gjuhës së huaj dhe sa shumë u duhet ta mësojnë atë. Mësuesit duhet të bëjnë të pamundurën për të pëmirësuar dhe mbajtur lartë motivimin.
- Interesi i studentëve** – është faktor i rëndësishëm, i lidhur ngushtë me motivimin. Gjatë shpjegimit mësuesit duhet të përpiqen të gjejnë tekste që zgjojnë interesat e nxënësve apo studentëve.
- Mosha** – Njerëzit e të gjithë moshave mund të mësojnë një gjuhë të re, por duhet të kemi parasysh që mosha është faktor kyç, pasi ndikon në cilësinë dhe në kohëzgjatjen e mësimin të një gjuhe.
- Frika dhe ankthi** – Askush nuk pëlqen dhe nuk

dëshiron të bëj gabime në komunikim por megjithatë nxënësit – studentët pavarësisht kesaj ata përpiqen të përdorin gjuhën e huaj si mjet komunikimi me të huajt.

- Vetbesimi** - Për njerëzit të cilët besojnë në vetvetë është shpesh më e lehtë të mësojnë një gjuhë të huaj se sa ata që kanë një shkallë besimi më të ulët. Kjo lidhet edhe me frikën ose ankthin e individit pasi ai nuk është i gatshëm dhe i përgatitur të ndërmarrë rreziqet.
- Qëndrimi i mësuesit** – Mënyra e cila shpjegon mësuesi është një faktor i rëndësishëm e lidhet me mësimin e gjuhëve të huaja në mënyrë sa më të mirë.
- Marrëdhëniet midis nxënësve – studentëve** – Bashkëpunimi, ndërveprimi nxënësve me njëri tjetrin ndikon shumë në mësimin e gjuhëve të huaja. Një klimë e qetë e favorshme në ambientet e mësimdhënies nuk është asgjë tjetër veç një tregues më cilësor për arritje sa më të larta.
- Personaliteti i nxënësit** – Është e rëndësishme që çdokush duhet të marrë në konsideratë personalitetin dhe dinjitetin e individit. Edhe pse nxënësi është gjithmonë përballë mësuesit ai ka personalitet dhe asnjëherë mësuesit nuk duhet ta anashkalojnë atë. Por nëse do të jesh një mësues i suksesshëm dhe i dashur nga të gjithë vlerëso dhe mbështet nxënësit në aktivitete ku ata të ndihen vetvetja, të ndihen të vlerësuar pse jo edhe të përkëdhelur në një hark kohor të shkurtër.

II. Faktorët socialë dhe kulturor kanë të bëjnë me

- Qëndrimet ndaj mësimin të gjuhës së huaj në disa shtete** - Mësimi i një gjuhe të huaj konsiderohet si diçka normale dhe e lehtë por në disa shtete të tjera konsiderohet si detyrim dhe përmbushje e kriterëve dhe standarteve. Këtu do të përmendim disa shtete si : Holanda ku pjesa më e madhe e njerëzve duhet të mësojnë të paktën 2 gjuhë të huaja. Shumë danezë flasin një Anglishte të shkëlqyer. Në Angli pak adoleshent mësojnë e flasin një gjuhë të huaj sepse ata e konsiderojnë mësimin e një gjuhe si një detyrë shumë të vështirë.
- Qëndrimi ndaj Anglishtes dhe shteteve Anglishtfolëse** – kuptohet që procesi i mësimin ndikohet nga qëndrimet e nxënësve drejt Anglishtfolësve vendas të anglishtes dhe kulturave të tyre. Kjo mund të ndikojë motivimin e nxënësve në veçanti.
- Statusi dhe vlera e gjuhës objektive** – Nxënësit mund të jenë më shumë të motivuar të mësojnë një gjuhë brenda kufijve të një shteti pasi ka më shumë vlerë.

III. Faktorët edukativë

- Mësuesit dhe nxënësit** – Mënyra si ata e shpjegojnë dhe mësojnë një gjuhë të huaj
- Shkollat dhe klasat** – hapësira dhe vendosja e objekteve shkollore
- Masmedia tekstet shkollore** – materialet suplementare, informacioni i kohës, literatura kontemporane etj, influencojnë shumë në mësimin e gjuhëve.
- Metodat, përfaqeset, tematikat dhe procedurat** –



Sa më shumë të përdorim metodat bashkëkohore, përfaqeset kontemporane – eklektive dhe të suksesshme aq më mirë mësohen gjuhët e huaja.

- **Koha e vlefshme për mësimin e gjuhëve** – sa më shumë kohë të shpenzojnë nxënësit duke mësuar diçka më e lehtë është të mësohet. Është e rëndësishme për nxënësit të praktikojnë gjuhët e huaj jashtë klasës sa më shumë të jetë e mundur.
- **Ngjashmëria e gjuhës vendase me gjuhën objektive** – në qoftë se gjuha e huaj është e ngjashme me gjuhën e nënës që përmban të njëjtin alfabet, tinguj etj është më e lehtë të mësohet.
- **Kultura e klasës** – Mësuesi duhet të krijojë një kulturë klase për të inkurajuar nxënësit të ndjejnë besim, konfidencë rreth marrjes së rreziqeve dhe përdorimit të një gjuhe të re. Të gjithë këta faktorë lidhen me njëri tjetrin dhe në të njëjtën kohë nga një faktor kompleks që influencën mësimin e gjuhës pozitivisht ose negativisht. Faktorët psikologjik, kulturor, social dhe arsimor (edukativ) shpesh zgjerohen, ndërthuren, ata nuk mund të qëndrojnë thjesht të vetmuar por lidhen me njëri tjetrin.

Shpjegimi tradicional i gjuhës së huaj përqëndrohet në marrjen e studentëve të rritur në mënyrë të vetëdijshme që të mësojnë gjithçka në izolim, pra shohim se metodat artificiale dhe arrijtjet shpesh nuk lidhen me situatën reale komunikuese. Thelbi i metodave tradicionale dhe alternative nuk është komunikimi por një pjesë e gjuhës që do të përdoret më vonë për të komunikuar. Mësimi i gjuhës është më i suksesshëm kur nxënësit përballen me situata komunikuese me një gjuhë objektive. Sa më shumë të përdor një individ gjuhën për të komunikuar aq më i mirë bëhet ky njeri, dhe aq më shumë përsosen dija dhe njohuritë e tij.

Është shumë e vështirë të parashikohet me saktësi kur duhet të mësohet një gjuhë, pasi jo në pak raste ndodh në mënyrë të vetëdijshme dhe të pavetëdijshme. Gjithçka është e lidhur ngushtë dhe varet nga individit për të krijuar një urë lidhëse me një kulturë dhe traditë tjetër. Të rriturit mësojnë një gjuhë të huaj ndryshë nga fëmijët,

sepse ata përveç mungesës së kohës dëshirojnë të shohin rezultate të shpejta. Ndërsa fëmijët duke pritur kohë të mjaftueshme kërkojnë një proces të ngadaltë për përvetësimin e gjuhës së huaj sepse bazohen fuqishëm në gjuhën vendase. Është shumë e rëndësishme të përkufizojmë mësimin dhe mësimdhënien dukë i parë nga këndvështrimi i mësuesit dhe i nxënësit.

Mësimi konsiston në kërkesën e njohurive. Mësimi ndikohet nga shumë faktorë psikologjik, kulturor, socialë dhe edukativ. Mësimi i gjuhës së huaj është mësimi i rregullave strukturave të gjuhës dhe fjalorit përmes aktiviteteve si leximi, shkrimi, përsëritja etj.

Mësimdhënia i jep studentëve eksperiencë dhe standarte të ndryshme të mësimin. Mësimdhënia mund të matet përmes metodave të mësimdhënies, përfaqesjeve dhe arrijtjeve. Ajo siguron një model të përdorimit të saktë të gjuhës. Mësimdhënia i ndihmon mësuesit t'i kalojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre te studenti.

Si të jemi të suksesshëm në mësuesit

- Të kemi njohuri të thelluar të gjuhës objektive.
- Të kemi aftësi studimi, të jemi seriozë në përdorimin e fushën e metodologjisë dhe t'a përdorin në mësimdhënien e përditshme.
- Të jemi gjithmonë të durueshëm, kërkuar e punëtorë.
- Të jemi mësues dhe nxënës në vetvete njëkohësisht.
- Të praktikojnë gjithçka që na është shpjeguar teorikisht.
- Të mbështesin studentët në procesin e mësimin duke përdorur aktivitete të ndryshme në klasë.
- Të tërheqin vëmendjen e studentëve përmes aktiviteteve Brenda klasës deri në fund të orës së mësimin.
- Të inkurajojmë studentët të jenë pjesëmarrës të denjë të fazat e procesit mësimorë, pasi vetëm në këtë mënyrë në arrijmë të krijojmë një klimë dhe arrijmë rezultate të larta.
- Sa më shumë teori të mësimdhënies të zotërojmë aq më të suksesshëm jemi në në procesin mësimorë.

Bibliografia

1. A History of English Language Teaching, Howatt, CUP, 1984
2. Approaches and Methods in Language Teaching, Richards & Rodgers, CUP, 2003
3. Aspects of Language Teaching, OUP, 1991
4. Motivation – The Teacher's Responsibility, Allwright, R, ELT Journal, 1977
5. Roles of Teachers & Learners, Tony Wright, OUP, 1996
6. Teaching and Learning English, OU Toolkit, UK, 2000
7. Teaching Foreign Language, Titone, Wahington, D.C., GUP, 1968
8. Teaching Foreign Language Skills, Chicago, 1981
9. The Practice of English Language Teaching, Jeremy Harmer, Longman, 1989